

SPECIFIKIMET TEKNIKE

1. Tabelat dhe elementet lidhëse

Tabelat duhet te jenë:

- Alumin, Klasi II (dytë);
- Me trashësi 2.5 ml dhe të lyer me bojë elektro-statike;
- Konform standartit ndërkombëtar **EN 12899-1** (ose ekuivalent)

Tabela duhet të lidhet në pjesën e sipërme dhe të poshteme të saj me mbajtësen duke garantuar soliditetin me një numër të mjaftuëshëm të bullonave prej çeliku të xinguar në pjesën e pasme të tabelës.

Ndërsa për evitimin e fenomeneve të vandalizmit, bullonat duhet të jenë të tilla që duke parë nga pjesa e pasme e tabelës kokat e tyre të jenë cilindrike me ekzagon brenda.

2. Kompozimi (përbërja e Celuloidit) e faqes së përparme të tabelës, (Adezivi):

Adezivi duhet të jetë konform standartit:

- **European EN-12899 RA2 ose SSH EN 12899 EN 12899-1,**
- **ETA08/0101 (ose ekuivalent)**

Koeficienti minimal fillestar i retroreflektivitetit e intensitetit të lartë Prizmatik, sipas matjeve të CIE54.2 duke përdorur standartet e iluminimit A, konform tabelës A dhe B.

Tabela A

Koeficientët minimal të retroreflektivitetit (dukshmërisë)

Këndi i vëzhgimit	Ngjyra	Këndi hyrës i dritës βI ($\beta_2=0^\circ$)		
		+ 5°	+ 30°	+ 40°
12' (0.2°)	Bardhë	250	150	110
	Verdhë	170	100	70
	Portokalli	100	60	29
	Blu	20	11	8
	Jeshile	45	25	12
	Kuqe	45	25	15
20' (0.33°)	Bardhë	180	100	95
	Verdhë	120	70	60
	Portokalli	65	40	20
	Blu	14	8.0	7.0
	Jeshile	21	12	11
	Kuqe	25	14	13
2°	Bardhë	5.0	2.5	1.5
	Verdhë	3.0	1.5	1
	Portokalli	1.5	1	-
	Blu	0.2	-	-
	Jeshile	0.5	0.3	0.2
	Kuqe	1	0.4	0.3

Tabela 2: Kromaticiteti gjate dites dhe Faktori i Luminances ^A

Ngjyra		Koordinatat e kutise se ngjyrave				Faktori Luminance β
		1	2	3	4	
Bardhe	x	0,305	0,335	0,325	0,295	$\geq 0,27$
	y	0,315	0,345	0,355	0,325	
Verdhe	x	0,494	0,470	0,513	0,545	$\geq 0,16$
	y	0,505	0,480	0,437	0,454	
Kuqe	x	0,735	0,700	0,610	0,660	$\geq 0,03$
	y	0,265	0,250	0,340	0,340	
Portokalle	x	0,610	0,535	0,506	0,570	$\geq 0,14$
	y	0,390	0,375	0,404	0,429	
Jeshile	x	0,110	0,170	0,170	0,110	$\geq 0,03$
	y	0,415	0,415	0,500	0,500	
Blu	x	0,130	0,160	0,160	0,130	$\geq 0,01$
	y	0,090	0,090	0,140	0,140	

Pjesa e Pasma e Tabelës

Në pjesën e pasme të tabelës, ashtu siç është parashikuar në Nenin 39 te Kodit Rrugor, duhet të shënohet enti pronar i rrugës, marka e firmës që ka prodhuar sinjalin viti i prodhimit si dhe numri i lejes që është dhënë kësaj firme nga Ministria e Transportit për prodhimin e sinjaleve rrugore. Të gjithë shënimet e mësipërme duhet të jenë të përmbledhura në një sipërfaqe jo më të madhe se 200 cm².

3.Boja akrilike (një komponent) dhe Boja Bikomponente:

a.BOJE BIKOMPONENTE:

Densiteti: 1.57 ± 0.06 kg/dm³ (20⁰C)
 Viskoziteti i komponentit A: 20-40 s DIN 53211-6 (20⁰C)
 Viskoziteti i komponentit B: 20-40 s DIN 53211-6 (20⁰C)
 Përmbajtje solide: Minimumi 99.8 peshë % pas hedhjes së katalizatorit dhe përfundimit të reaksionit.
 Raporti i përzierjes: Komponenti A: katalizator i lëngshëm =96:4
 Komponenti B: komponenti B = 1:1

b.BOJE AKRILIKE:

Densiteti: 1.63 ± 0.04 kg/dm³ (20⁰C)
 Viskoziteti i komponentit A: 20-45 s DIN 53211-6 (20⁰C)
 Përmbajtje solide: Minimumi 75.0 peshë %.

Boja duhet të jetë e ambalazhuar në kova me peshë nga 30 kg.
 Në trupin e kovës duhet të shënohet data e prodhimit dhe/ose skadencës së saj.

4.FOSFORI (Perlina Xhami): I shtohet bojës bikomponente për të krijuar fosforin dhe për tu përdorur në vijëzimin e rrugëve në përputhje me standartin shqiptar (SSH EN 1436 ose ekuivalent)

Madhësia e kokrrës: 300-850 μm

Indeksi i reflektivitetit: ≥ 1.6 Klasa A sipas EN 1423 ose ekuivalent

Rrumbullaksia: $\geq 85\%$

Densiteti: -1.8

Veshja: T14

	Rruaza dhe përzierja	
	Madhësia e sitës μm	Mbajtja e akumuluar në %
Gama e sitës sipas	1000	0
SSH EN 1423 CE 1628	850	0-10
	500	30-70
	300	95- 100